



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:029114

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05729722

C.nr.525/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, me bashkëpunëtoreshen profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditësve F.R. me numër personal F.B. me numër personal H.Th. me numër personal H.G. me numër personal H.H. me numër personal dhe Il.B. me numër personal që të gjithë nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av.B.Gj. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 17,896.61 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 24.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve F.R., F.B., H.Th., H.G., H.H. dhe Il.B. që të gjithë nga Prizreni, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

II. DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, ti paguaj shumat si në vijim:

- Paditëses F.R. për periudhën kohore prej datës 14.02.2019 deri më datë 30.04.2021 apo për 26 muaj e 15 ditë (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, si dhe për 15 ditë shumën prej 29.64 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë – 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 1,468.74 euro;
- Paditësit F.B. për periudhën kohore prej datës 14.02.2019 deri më datë 30.04.2021 apo për 26 muaj e 15 ditë (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, si dhe për 15 ditë shumën prej 29.64 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë – 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 1,468.74 euro;
- Paditëses H.Th. për periudhën kohore prej datës 14.02.2019 deri më datë 30.04.2021 apo për 26 muaj e 15 ditë (për çdo muaj shumën prej 61.76 euro, si dhe për 15 ditë shumën prej 33.07 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë – 462.76 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 1,638.83 euro;
- Paditësit H.G. për periudhën kohore prej datës 14.02.2019 deri më datë 30.04.2021 apo për 26 muaj e 15 ditë (për çdo muaj shumën prej 65.15 euro, si dhe për 15 ditë shumën prej 34.89 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë – 495.30 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 1,728.79 euro;
- Paditësit H.H. për periudhën kohore prej datës 14.02.2019 deri më datë 30.04.2021 apo për 26 muaj e 15 ditë (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, si dhe për 15 ditë shumën prej 29.64 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë – 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 1,468.74 euro;

- Paditësit Il.B. për periudhën kohore prej datës 14.02.2019 deri më datë 30.04.2021 apo për 26 muaj e 15 ditë (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, si dhe për 15 ditë shumën prej 29.64 euro, në shkallë prej 27 % të pagës bazë – 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit), t'ia paguajë shumën prej 1,468.74 euro;

Të gjitha këto shuma me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 14.02.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditësve, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 412.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, përtej shumës së gjykuar si në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 17,896.61 euro, përkatësisht shuma prej 8,654.03 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

A r s y e t i m

Paditësit F.R., F.B., H.Th., H.G., H.H. dhe Il.B. që të gjithë nga Prizreni, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson av.B.Gj. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 17,896.61 euro.

I autorizuari i paditësve në padi kanë theksuar, se paditësit janë të punësuar si mësimdhënës pranë SHFMU "Ibrahim Fehmiu" në Prizren, ku vazhdojnë të punojnë në këtë institucion. Tutje, ka theksuar se meqë paditësit janë të licencuar dhe të kualifikuar mësimdhënës me nivel Bachelor me diplomë fakulteti në bazë të nenit 7 par.1.3 të Kontratës Kolektive me numër të protokollit 2056 të datës 18.04.2017, të njëjtëve iu është garantuar e drejta në pagesë shtesë prej 27% të pagës bazë, çka e paditura e ka paguar pjesërisht. Duke kërkuar nga gjykata kompensimin mbi këtë bazë për 9 muaj të vitit 2017, 12 muaj për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 4 muaj për vitin 2021, apo gjithsej 49 muaj për secilin paditës. Paditësja F.R. realizon pagë prej 445.10 euro, ndërsa shtesën prej 27% të kësaj page apo shuma prej 120,17 €, e paditura ia paguan vetëm pjesërisht dhe atë shumën prej 60.17€, duke i mbetur borxh në shumën prej 60.00 euro, apo në shumën e tërësishme prej 2,940€. Paditësi F.B. realizon pagë prej 468.56 euro, ndërsa shtesën prej 27% të kësaj page apo shuma prej 126,51€, e paditura ia paguan vetëm pjesërisht dhe atë shumën prej 63.51€, duke i mbetur borxh në shumën prej 63.00 euro, apo në shumën e tërësishme prej 3,087€. Paditësja H.Th. realizon pagë prej 462.76 euro, ndërsa shtesën prej 27% të kësaj page apo shuma prej 124,94 €, e paditura ia paguan vetëm pjesërisht dhe atë shumën prej 62.94€, duke i mbetur borxh në shumën prej 62.00 euro, apo në shumën e tërësishme prej 3,038€. Paditësi H.G. realizon pagë prej 586.90 euro, ndërsa shtesën prej 27% të kësaj page apo shuma prej 158,46 €, e paditura ia paguan vetëm pjesërisht dhe atë shumën prej 79.46€, duke i mbetur borxh në shumën prej 79.00 euro, apo në shumën e tërësishme prej 3,871€. Paditësi H.H. realizon pagë prej 487.59 euro, ndërsa shtesën prej 27% të kësaj page apo shuma prej 131,64 €, e paditura ia paguan vetëm pjesërisht dhe atë shumën prej 66.00€, duke i mbetur borxh në shumën prej 65.64 euro, apo në shumën e tërësishme prej 2,100.48€. Paditësi Il.B. realizon pagë prej 434.73 euro, ndërsa shtesën prej 27% të kësaj page apo shuma prej 117,37 €, e paditura ia paguan vetëm pjesërisht dhe atë shumën prej 59.00€,

duke i mbetur borxh në shumën prej 58.37 euro, apo në shumën e tërësishme prej 2,860.13€. Të gjitha këto me kamat ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësve se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha benificioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke theksuar se e drejta e paditëse për kompensim të kualifikimit për vitet 2017 e deri në parashtrimin e padisë së parashkruar, sipas nenit 353 të LMD-së kjo e drejtë është parashkruar, sepse kanë kaluar mbi 3 vite. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadija e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditësve është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësit F.R., F.B., H.Th., H.G., H.H. dhe Il.B. janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë SHFMU “Ibrahim Fehmiu” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësve u takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar, si dhe nëse kërkesa e paditësve për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Gjykata përmes kontratës së punës nr. 10/215 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, nga vërtetimi me numër protokoll 255/04-19 të datës 23.06.2021, të lëshuar nga drejtori i shkollës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja F.R. është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 1257, e datës 10.04.2018, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit- Qendra në Prizren, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i programit fillor. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Gjykata përmes kontratës së punës nr. 45/70 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, nga vërtetimi me numër protokoll 255/04-20 të datës 23.06.2021, të lëshuar nga drejtori i shkollës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi F.B. është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar, respektivisht i njëjti ka të

përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 115, e datës 25.06.2013, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit-Qendra në Prizren, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i programit matematikë-informatikë. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Gjykata përmes kontratës së punës nr. 7/139 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, nga vërtetimi me numër protokoll 255/04-21 të datës 23.06.2021, të lëshuar nga drejtori i shkollës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja H.Th. është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 466, e datës 22.07.2015, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit- Qendra në Prizren, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i programit fillor. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, dhe Njoftimi/Përgjigja e MASHT-it me numër protokoll 4540 e datës 11.12.2023, për lartësinë e pagave të stafit arsimor, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 495.30 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 63.18 euro.

Gjykata përmes kontratës së punës nr. 01-112-155810/01 e datës 19.10.2018, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, nga vërtetimit me numër protokoll 255/04-01 të datës 23.06.2021, të lëshuar nga drejtori i shkollës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi H.G. është në marrëdhënie pune pranë të paditurës në pozitën e drejtorit të shkollës, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin filozofik, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 3574, e datës 04.04.1983, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik, në emër të paditësit, ku i njëjti ka marrë titullin profesor i letërsisë dhe i gjuhës shqipe. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, dhe Njoftimi/Përgjigja e MASHT-it me numër protokoll 4540 e datës 11.12.2023, për lartësinë e pagave të stafit arsimor, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 495.30 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 68.58 euro.

Gjykata përmes kontratës së punës nr. 01/267 e datës 03.09.2018, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, nga vërtetimit me numër protokoll 255/04-22 të datës 23.06.2021, të lëshuar nga drejtori i shkollës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi H.H. është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 664, e datës 19.04.2016, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit-Qendra në Prizren, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i gjuhës dhe letërsisë angleze. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Gjykata përmes kontratës së punës nr. 23/135 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës, nga vërtetimit me numër protokoll 255/04-23 të datës 23.06.2021, të lëshuar nga drejtori i shkollës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi Il.B. është në marrëdhënie pune pranë të paditurës, kualifikimi i paditësit është kualifikim universitar, respektivisht i njëjti ka të përfunduar fakultetin e edukimit dhe studimet i ka mbaruar me datë 24.06.2017, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 1392, e datës 03.09.2021, e lëshuar nga Universiteti i

Prishtinës, Fakulteti i Edukimit-Qendra në Prizren, në emër të paditëses, ku e njëjta ka marrë titullin bachelor i gjuhës dhe letërsisë angleze. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësve t’ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditësve F.R., F.B., H.Th., H.G., H.H. dhe Il.B. ia ka paguar shumën prej 58.32 euro, ndërsa paditëses H.Th. ia ka paguar shumën prej 63.18 euro, ndërsa paditësit H.G. ia ka paguar shumën prej 68.58 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 4 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësit F.R., F.B., H.Th., H.G., H.H. dhe Il.B. përfitojnë ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësit F.R., F.B., H.Th., H.G., H.H. dhe Il.B. përfitojnë ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro, ndërsa paditësit H.Th. dhe H.G. përfitojnë ngritje në shumën prej 133.73 euro. Mirëpo, bazuar në provat e paraqitura nga vet pala paditëse gjykata ka vërtetuar se paditësja H.Th. ka pagën bazë në lartësi prej 495.30 euro, por meqë paditësja H.Th. ka kërkuar nga gjykata kompensimin në emër të kualifikimit mbi pagën bazë në lartësi prej 462.76 euro, gjykata llogaritjen e 27% e ka bërë mbi këtë pagë, kjo bazuar në nenin 2.1 të LPK-së. Në këtë drejtim, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësve F.R., F.B., H.Th., H.G., H.H. dhe Il.B. për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro, për periudhën kohore prej datës 14.02.2019 deri më datë 30.04.2021 apo për 26 muaj e 15 ditë, shumën e përgjithshme prej 1,468.74 euro,

($26 \times 55.35 = 1,439.10$ euro si dhe për 15 ditë $55.35/28 = 1.976 \times 15 = 29.64$), ashtu që ($1,439.10 + 29.64 = 1,468.74$ euro), ndërsa paditëses H.Th. për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 61.76 euro, për periudhën kohore prej datës 14.02.2019 deri më datë 30.04.2021 apo për 26 muaj e 15 ditë, shumën e përgjithshme prej 1,638.83 euro, ($26 \times 61.76 = 1,605.76$ euro si dhe për 15 ditë $61.76/28 = 2.205 \times 15 = 33.07$), ashtu që ($1,605.76 + 33.07 = 1,638.83$ euro), si dhe paditësit H.G. për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 65.15 euro, për periudhën kohore prej datës 14.02.2019 deri më datë 30.04.2021 apo për 26 muaj e 15 ditë, shumën e përgjithshme prej 1,728.79 euro, ($26 \times 65.15 = 1,693.90$ euro si dhe për 15 ditë $65.15/28 = 2.326 \times 15 = 34.89$), ashtu që ($1,693.90 + 34.89 = 1,728.79$ euro).

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 14.02.2022, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 16.02.2022, ndërsa kërkesa e tij ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar sipas nenit 87 të LP-së për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 13.02.2019. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, kërkesa e paditësve e cila është parashkruar rezulton të jetë në shumën prej 8,654.03 euro, bazuar në shumën e kërkuar nga pala paditëse dhe pjesës aprovuese sipas arsyeve të theksuara më lartë.

Më saktësisht, gjykata vlerëson se përkundër faktit se paditësve e drejta për kompensimin e pagës shtesë mbi bazën e kualifikimit i është bërë e arritshme në fund të muajit- fillim të muajit, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, në mënyrë specifike dhe konkrete përcaktohet se kërkesat e tilla ndërpriten me rastin e parashtrimit të kërkesës- padisë, sipas nenit 369 të LMD-së. Kështu, paditësit kanë ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe kanë ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së tyre në procedurë gjyqësore nga data 14.02.2019 deri më datë 30.04.2021. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Numri i lëndës: 2022:029114
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05729722

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449, 452 par.2 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëses t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 412.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumë prej 312.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumë prej 100.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.525/2022, datë 24.05.2024

Gjyqtari,
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.